



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 81

16 maj

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 8151 datë 2.5.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3435
Dekret nr. 8152 datë 7.5.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3435
Dekret nr. 8153 datë 7.5.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3436
Vendim i KM nr. 373, datë 3.5.2013	Për emërim në detyrë.....	3436
Vendim i KM nr. 379, datë 2.5.2013	Për përcaktimin e Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit, si përfaqësuese në Këshillin Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e përfituesve të këtij fondi.	3437
Vendim i KM nr. 380, datë 2.5.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 89, datë 16.1.2013 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2013”.....	3437
Vendim i KM nr. 381, datë 2.5.2013	Për rishpërndarje fondesh, brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Financave, në buxhetin e vitit 2013.....	3438
Vendim i KM nr. 382, datë 2.5.2013	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe teknologjik.....	3438
Vendim i KM nr. 383, datë 2.5.2013	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, për bashkëpunim në fushën e arsimit.....	3441

Vendim i KM nr. 385, datë 2.5.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Leshnjë të qarkut të Beratit.....	3444
Vendim i KM nr. 386, datë 2.5.2013	Për rishpërndarje fondesh buxhetore brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë, në buxhetin e vitit 2013.....	3445
Vendim i KM nr. 388, datë 2.5.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontratues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Bregu i Madh” dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë.....	3446
Vendim i KM nr. 389, datë 2.5.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 1293, datë 29.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në Këshillin Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar.....	3446
Vendim i KM nr. 390, datë 2.5.2013	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Fierit.....	3447
Vendim i KM nr. 392, datë 2.5.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 141, datë 20.2.2013 të Këshillit të Ministrave “Për autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për lidhjen e shtesës së kontratës me studion e avokatisë, të përzgjedhur për përfaqësimin në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar kundër shoqërisë “CEZ” A.S”.....	3447
Vendim i KM nr. 394, datë 10.4.2013	Për përcaktimin e autoriteteve kontraktuese, përkatësisht Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, për dhënien me koncesion të ndërtimit të landfillit për trajtimin e mbetjeve të qarkut të Durrësit dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë “Albania Landfill Energy A.L.E.”.....	3448
Vendim i KLD nr. 319, datë 3.5.2013	Për kriteret dhe mënyrën e delegimit të gjyqtarëve për shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore.....	3448
Udhëzim i KMDHP nr. 35, datë 7.5.2013	Për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore.....	3456
Vendim i ERRU nr. 19, datë 22.4.2013	Për rinovim licence sh.a. ujësjellës-kanalizime Durrës.....	3458
Vendim i ERRU nr. 20, datë 30.4.2013	Për rinovim licence sh.a. ujësjellës-kanalizime Mat.....	3459
Vendim i ERRU nr. 21, datë 30.4.2013	Për rinovim licence sh.a. ujësjellës-kanalizime Delvinë.....	3459
Kërkesë e MPPT nr. 467/10 datë 3.5.2013	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës)”.....	3460
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të shtetasit Gëzim Hajdari.....	3463

DEKRET
Nr. 8151, datë 2.5.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 7 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:
Ilir Besim Bokshi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8152, datë 7.5.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Roberto Antonio Caparrotta
2. Julien Emile-Joseph Pierre Marie Pascal Coustaury

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 8153, datë 7.5.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Anida Sazan Kelmendi
2. Shefqet Rustem Kelmendi
3. Jakup Hamid Rroji
4. Hazir Mehmet Mustafaj
5. Izmir Hazir Mustafaj
6. Salihe Lilo Idriizi (Lilaj)
7. Xhuma Qerim Meka
8. Lindita Skender Meka
9. Igli Xhuma Meka
10. Avni Xhuma Meka
11. Lediane Xhuma Çollaku (Meka)
12. Sanije Ramiz Xhaferi
13. Genci Pandeli Shtëmbari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 373, datë 3.5.2013

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Afërdita Zeri emërohet zëvendësministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 379, datë 2.5.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E ZYRËS PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT, SI PËRFAQËSUESE
NË KËSHILLIN ADMINISTRATIV TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR, E PËRFITUESVE TË KËTIJ FONDI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përcaktimin e Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit, si përfaqësuese në Këshillin Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e përfituesve të këtij fondi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 380, datë 2.5.2013

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 89, DATË 16.1.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR CAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË
MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN
RURAL PËR VITIN 2013”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4.21 të vendimit nr. 89, datë 16.1.2013 të Këshillit të Ministrave, të shtohet pika 4.22 me këtë përmbajtje:

“4.22 Kompensimi i tatimit mbi vlerën e shtuar që fermeri ka paguar në blerjen e *inputeve* bujqësore dhe kafshëve të racës, të tilla si: plehrat kimike, pesticide, farëra, fidanë frutorë, mëshqerra racë e pastër, të imëta racë e pastër, material biologjik për ndërzim, ushqime për kafshë, materiale për bletarinë, plastmasë për serra.

Kompensim i tatimit mbi vlerën e shtuar bëhet bazuar në faturën e blerjes me TVSH.

Kriteret dhe procedura e kompensimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Efektet financiare të këtij kompensimi të përballohen nga buxheti i vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 381, datë 2.5.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, BRENDA PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR
MINISTRINË E FINANCEVE, NË BUXHETIN E VITIT 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Financave, bëhet rishpërndarja e fondeve brenda programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, zëri “shpenzime kapitale”, të pakësohet fondi prej 8 (tetë) milionë lekësh.

b) Në programin buxhetor 01150 “Menaxhimi i të ardhurave doganore”, zëri “shpenzime kapitale”, të shtohet fondi prej 8 (tetë) milionë lekësh, për projektin “Implementimi i modulit të pagesave elektronike të doganës”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 382, datë 2.5.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT,
PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, INDUSTRIAL DHE TEKNOLOGJIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe teknologjik, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, INDUSTRIAL DHE TEKNOLOGJIK

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Azerbajxhanit, më poshtë të quajtura “Palët Kontraktuese”,

- *në mbështetje* të marrëdhënieve miqësore ndërmjet shteteve të tyre dhe popujve të tyre;
- *me synim* asistimin e zhvillimit të bashkëpunimit në fushat e ekonomisë, industrisë dhe teknologjisë në bazë të barazisë, përfitimit të përbashkët dhe reciprocitetit;
- *duke marrë parasysh* përfitimin e përbashkët që rrjedh nga zgjerimi i mundësive të marrëdhënieve dypalëshe afatgjata dhe të suksesshme dhe me dëshirën për të intensifikuar më tej marrëdhëniet nëpërmjet nxitjes së një bashkëpunimi më të mirë;
- *duke marrë parasysh* detyrimin e shteteve të tyre që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare; kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese nxisin zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik, industrial dhe teknologjik në fushën me interes dhe përfitim të përbashkët në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse të brendshme të shteteve të tyre dhe marrëveshjeve ndërkombëtare ku ato janë palë.

Neni 2

Organet përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë sa më poshtë:
Për Republikën e Shqipërisë - Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
Për Republikën e Azerbajxhanit - Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Neni 3

Palët Kontraktuese përpiqen të krijojnë kushte të favorshme për të forcuar bashkëpunimin ekonomik, veçanërisht nëpërmjet:

- krijimit të kushteve të favorshme për investime;
- shkëmbimit të informacionit mbi biznesin dhe ekonominë;
- hapjes së tregjeve të reja;
- krijimit të ndërmarrjeve të përbashkëta, xhiros tregtare, investimeve, gjithashtu, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet dhomave të industrisë dhe tregtisë, shoqatave të biznesit dhe organizatave të biznesit të të dyja vendeve;
- aktiviteteve të tjera të rëna dakord bashkërisht nga Palët Kontraktuese.

Neni 4

Palët Kontraktuese, me synim zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik, shkëmbejnë informacion mbi legjislacionin e tyre të brendshëm dhe programeve shtetërore, si dhe çështje të tjera të interesit të përbashkët, në pajtim me legjislacionet e tyre të brendshme.

Neni 5

1. Bashkëpunimi në nenin 3 ka të bëjë me fushat e mëposhtme:
 - industrinë, gjithashtu, aktivitetin në fushën e energjisë;



- bujqësinë;
- ndërtimin;
- transportin;
- bankat, figuracionet dhe shërbime të tjera financiare;
- turizmin;
- fusha të tjera të interesit të përbashkët.

2. Palët Kontraktuese zhvillojnë konsultime për qëllimin e identifikimit të fushave prioritare, si dhe drejtimet ekonomike, industriale dhe teknologjike të bashkëpunimit të tyre.

Neni 6

1. Bashkëpunimi në fushat ekonomike, industriale dhe teknologjike sipas kësaj marrëveshjeje realizohet brenda kuadrit të legjislacionit të brendshëm të Palëve Kontraktuese mbi bazën e marrëveshjeve dhe kontratave ndërmjet ndërmarrjeve, organizatave dhe firmave të Shqipërisë dhe Azerbajxhanit.

2. Palët Kontraktuese, nëpërmjet krijimit të kushteve të favorshme për bashkëpunimin në fushat e ekonomisë, industrisë dhe teknologjisë, bëjnë të gjitha përpjekjet në drejtimet e mëposhtme:

- përgatitja e një marrëveshjeje në fushën e transportit për realizimin e transportit të kombinuar ndërmjet të dyja vendeve;
- diskutimi dhe miratimi i programeve për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe teknologjik në fushat e interesit të përbashkët;
- përgatitja e programeve për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe realizimi i tyre;
- pjesëmarrja e biznesmenëve në ekspozita dhe panairë të mbajtura në territoret e Palëve Kontraktuese, gjithashtu, edhe krijimi i kushteve të favorshme për investime të përbashkëta.

Neni 7

1. Palët Kontraktuese krijojnë kushte të favorshme për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe teknologjik, duke përfshirë ato ndërmjet organizatave dhe firmave.

2. Ky bashkëpunim mund të realizohet si më poshtë:

- përgatitjes së programeve të përgjithshme të kërkimit dhe të zhvillimit;
- organizimit të vizitave të përbashkëta të delegacioneve;
- organizimit të programeve edukative në fushat e interesit të përbashkët;
- shkëmbimit të eksperiencës dhe të njohurive shkencore dhe teknike;
- organizimit të simpoziumeve dhe të takimeve.

Neni 8

Në pajtim me këtë marrëveshje, ngrihet grupi i punës për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe teknologjik, të përbërë nga përfaqësuesit e palës shqiptare dhe palës azerbajxhanase.

Grupi i punës mblidhet të paktën një herë në vit, një herë në Shqipëri dhe një herë në Azerbajxhan.

Neni 9

Kjo marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese, që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare ku janë palë.

Neni 10

Palët Kontraktuese i zgjidhin mosmarrëveshjet dhe konfliktet që rrjedhin nga interpretimi dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje nëpërmjet konsultimeve dhe marrëdhënieve të përbashkëta.

Neni 11

Shtesat dhe ndryshimet që mund t'i bëhen kësaj marrëveshjeje me pëlqimin e përbashkët të Palëve Kontraktuese në formën e protokolleve të veçanta janë pjesë e kësaj marrëveshjeje, hyjnë në fuqi në pajtim me nenin 12 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të papërcaktuar kohe dhe hyn në fuqi në datën e marrjes nga Palët Kontraktuese të njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, që konfirmon përfundimin e procedurave të tyre përkatëse të brendshme, që kërkohen për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Palët Kontraktuese mund ta prishin këtë marrëveshje me njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Prishja e kësaj marrëveshjeje hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi.

Bërë në Baku, më 8 prill 2013, në dy kopje origjinale, secila prej tyre në gjuhën shqipe, azerbajxhanase dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllëj autentike. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

VENDIM

Nr. 383, datë 2.5.2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E ARSIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, për bashkëpunim në fushën e arsimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË FUSHËN E ARSIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi, më poshtë të quajtura “Palë”,

- të udhëhequra nga dëshira për të zhvilluar bashkëpunimin me përfitim të ndërsjellë në fushën e arsimit;

- të bindur se bashkëpunimi në këtë fushë do të kontribuojë në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve,

kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Të dyja palët do të inkurajojnë dhe do të mbështesin bashkëpunimin dhe zhvillimin në fushën e arsimit brenda kuadrit ligjor dhe në bazë të interesit të përbashkët të secilës palë. Ato do të sigurojnë shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit lidhur me procedurat aktuale ligjore dhe strukturën e institucioneve arsimore të të dyja vendeve.

Neni 2

Të dyja palët do të inkurajojnë dhe do të mbështesin vendosjen e lidhjeve të drejtpërdrejta midis strukturave përkatëse në nivel të ministrive, të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të arsimit të lartë.

Neni 3

Të dyja palët do të mbështesin dhe do të promovojnë një bashkëpunim të zgjeruar të institucioneve të tyre në kuadër të programeve arsimore rajonale, ndërkufitare dhe ndërkombëtare.

Neni 4

Të dyja palët do të mbështesin dhe do të inkurajojnë:

a) shkëmbimin dhe vlerësimin e eksperiencave në reformën e sistemit arsimor të secilit vend, si dhe të proceseve arsimore me qëllim përfitimin e njohurive nga praktikat më të mira;

b) shkëmbimin e personelit akademik midis institucioneve të arsimit të lartë me traditën e bashkëpunimit të mirë;

c) bashkëpunimin dhe aktivitete të tjera, që synojnë zgjerimin e shkëmbimeve në fushën e arsimit.

Neni 5

Me qëllim zhvillimin e një sistemi arsimor modern, të qëndrueshëm dhe demokratik, si dhe në mbështetje të rritjes ekonomike, zhvillimit dhe integritetit të vlerave të shoqërisë në proceset e zhvillimit rajonal, të dyja palët do të kenë shkëmbime në nivelet e arsimit parauniversitar mbi:

1. Reformat në kurrikula;

2. Përmirësimin e nivelit arsimor dhe trajnimit profesional të mësuesve;

3. Veprimtari të përgjithshme arsimore dhe kulturore, si dhe projekte në nivel shkollash, duke përfshirë binjakëzime shkollash, shkëmbime grupesh dhe nxënësish.

Neni 6

Të dyja palët do të shkëmbejnë vazhdimisht informacione ndërmjet shkollave parauniversitare nëpërmjet partneritetit të orientuar në fushat me interes të ndërsjellë.

Neni 7

Të dyja palët do të angazhohen në shkëmbimin e përvojës në fushën e krijimit dhe të sigurimit të teksteve shkollore.

Neni 8

Në fushën e arsimit dhe formimit profesional, të dyja palët shprehin angazhimin e tyre për vendosjen e bashkëpunimit në arsimin profesional dhe teknik, dhe në fusha me interes të përbashkët.

Neni 9

Në nivel universitar, të dyja palët do të ofrojnë çdo vit bursa për studime universitare, pasuniversitare dhe kërkimore mbi parimin bazë të reciprocitetit. Kandidatët do të përzgjidhen nga pala dërguese.

Neni 10

Të dyja palët do t'i ofrojnë çdo vit njëra-tjetrës vizita studimore për kërkuesit e rinj me një kohëzgjatje prej 1-2 muajsh.

Neni 11

Të dyja palët do të inkurajojnë studime të përbashkëta me interes të ndërsjellë, duke përfshirë studimet e gjuhës dhe të letërsisë. Palët do të mbështesin, gjithashtu, zhvillimin e programeve të përbashkëta (si gradat e përbashkëta në nivel pasuniversitar) në fusha, si: inxhinieri, shkenca hidrike, shkenca mjedisore dhe energjetike etj. Të dyja palët do të angazhohen në shkëmbimin e lektorëve, profesorëve dhe ekspertëve në fusha të ndryshme.

Neni 12

Të dyja palët do të nxisin angazhimin e stafit akademik të institucioneve të arsimit të lartë në projekte të përbashkëta kërkimore dhe shkencore.

Neni 13

Të dyja palët do të promovojnë lëvizjen e lirë të studentëve në të gjitha nivelet e arsimit të lartë. Për studentët e pranuar, pala pritëse do të ofrojë përjashtimin e tyre nga tarifat e regjistrimit/pagesat e shkollimit, si dhe përjashtimin nga taksat e lejeqëndrimit.

Neni 14

Të dyja palët do të bashkëpunojnë për hartimin e një marrëveshjeje për njohjen reciproke të certifikatave, diplomave, titujve dhe gradave shkencore, të lëshuara nga institucionet arsimore respektive. Në nivelin e arsimit të mesëm, do të njihen diplomat e Maturës Shtetërore të secilit vend.

Neni 15

Në realizimin e kësaj marrëveshjeje, palët do të ngrenë një komitet të përbërë nga anëtarë të secilës palë dhe me fokus të bashkëpunimi për arsimin. Komiteti i përbashkët do të takohet periodikisht në kryeqytetin e secilit vend, me rotacion. Secila palë do të mbulojë shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit të anëtarëve të saj gjatë takimeve.



Neni 16

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pasi palët të kenë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike se kanë përbushur procedurat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të saj.

Neni 17

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 18

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë pesëvjeçare dhe do të rinovohet automatikisht për një periudhë tjetër pesëvjeçare, përveç kur njëra palë njofton me shkrim mbi qëllimet e saj për të përfunduar këtë marrëveshje të paktën gjashtë muaj para datës së përfundimit.

Bërë në Tiranë, më 11 mars 2013, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

VENDIM

Nr. 385, datë 2.5.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS LESHNJË TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Leshnjë të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Leshnjë të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr. 686, datë 3.10.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Leshnjë të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Leshnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Leshnjë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
86-91	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
92	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
93-102	Varrezat publike	Në pronësi
103-119	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
120-134	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
135-149	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	
153-179	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
180-187	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM

Nr. 386, datë 2.5.2013

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE BRENDA PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, NË BUXHETIN E VITIT 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore, në buxhetin e vitit 2013, zëri “Shpenzime korente”, brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë, si më poshtë vijon:

a) programit të sistemit të burgjeve t’i pakësohet fondi prej 7 150 000 (shtatë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për shpenzime personeli;

b) programit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor t’i pakësohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për shpenzime personeli;

c) programit të Shërbimit të Provës t’i shtohet fondi prej 9 150 000 (nëntë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për shpenzime personeli.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 388, datë 2.5.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRATUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
HIDROCENTRALIT “BREGU I MADH” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN
PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3 e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Bregu i Madh” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë “Zaloshnja HL” sh.p.k., për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali.
 3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Bregu i Madh”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.
 4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 389, datë 2.5.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1293, DATË 29.12.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE,
PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 10 130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Shkronja “b” e pikës 2 të vendimit nr. 1293, datë 29.12.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:
- “b) Z. Florjon Mima, Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 390, datë 2.5.2013

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Shkëlqim Murati emërohet prefekti i qarkut të Fierit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 392, datë 2.5.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 141, DATË 20.2.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS PËR LIDHJEN E SHITESËS SË KONTRATËS ME STUDIO E AVOKATISË,
TË PËRZGJEDHUR PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR KUNDËR SHOQËRISË “CEZ” A.S”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, 5 pika 1 shkronja “b”, 12, pikat 2 e 6, 15, pika 8 dhe 18, pika 2 të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr. 141, datë 20.2.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Shpenzimet për pagimin e studios së avokatisë, në vlerën 900 000 (nëntëqind mijë) euro, për kontratën “Për ofrimin e shërbimeve nga studioja ligjore “Derains & Gharavi”, si dhe për shtesën e kontratës, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit për vitin 2013.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 394, datë 10.4.2013

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE, PËRKATËSISHT MINISTRINË E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE DHE MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË NDËRTIMIT TË LANDFILLIT PËR TRAJTIMIN E MBETJEVE TË QARKUT TË DURRËSIT DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË “ALBANIA LANDFILL ENERGY A.L.E.”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 96 663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoritete kontraktuese për kryerjen e procedurave ligjore dhe dhënie me koncesion të ndërtimit të landfillit për trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane të qarkut të Durrësit janë: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
2. Miratimin e bonusit prej 6% të pikëve, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, si propozim i pakërkuar, që i jepet shoqërisë “Albania Landfill Energy A.L.E.”.
3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 319, datë 3.5.2013

PËR KRITERET DHE MËNYRËN E DELEGIMIT TË GJYQTARËVE PËR SHQYRTIMIN E NJË ÇËSHTJEJE GJYQËSORE

Në zbatim të neneve 1 dhe 2 shkronja “f” të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 21 pika 2 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë

VENDOSI:

Neni 1

Paraqitja e kërkesës për delegim

1. Në rastet kur një gjykatë nuk ka mundësi të shqyrtojë një ose disa çështje brenda afateve të arsyeshme kohore, Kryetari i gjykatës, jo më vonë se tri ditë pune nga verifikimi i situatës konkrete, i drejtohet Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbi nevojën konkrete të delegimit të gjyqtarëve mbi një ose disa çështje.
2. Një gjykatë nuk ka mundësi të shqyrtojë një çështje gjyqësore brenda afateve të arsyeshme kohore, kur:

a) asnjë gjyqtar i saj nuk mund të marrë pjesë në gjykimin e çështjes për shkak të përjashtimit apo të heqjes dorë nga gjykimi sipas procedurave të përcaktuara në ligj;

b) numri i gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht funksionin në gjykatë në kohën e gjykimit të çështjes është më i ulët se sa numri i kërkuar për formimin e trupit gjykues të kërkuar nga ligji.

3. Kërkesa për delegim formulohet sipas modelit standard në aneksin 1 të bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij. Ajo shoqërohet me të gjitha aktet që vërtetojnë pamundësinë e gjykatës për të shqyrtuar çështjen objekt delegimi sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 2

Parimet dhe kriteret e delegimit

1. Procesi i delegimit bazohet në parimet e pavarësisë, të paanësisë dhe të palëvizshmërisë së gjyqtarit në gjykimin e çështjeve, si dhe në parimin e transparencës.

2. Delegimi autorizohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe bëhet me short ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave në të njëjtin nivel gjykimi.

3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në përcaktimin e gjyqtarëve për delegim, në varësi të objektit të çështjes gjyqësore për të cilën nevojitet delegimi, mban parasysh kriteret sipas radhës së mëposhtme:

a) afërsinë gjeografike të gjykatës në nevojë delegimi dhe asaj nga e cila do të delegohen gjyqtarë. Nëse midis dy gjykatave me afërsi gjeografike konkurruese, ngarkesa totale e punës është e diferencuar, ky kriter i fundit merr përparësi në zgjedhjen e gjykatës për delegim;

b) ndarjen e gjyqtarëve në dhoma civile ose penale, si dhe seksionet brenda dhomës civile;

c) ngarkesën e gjyqtarëve në gjykatën nga ku delegohen.

Neni 3

Mbledhja e të dhënave të nevojshme

1. Për mundësimin e aplikimit të kriterëve të delegimit, kryetari i gjykatës së rrethit gjyqësor apo i gjykatës së apelit i komunikon Këshillit të Lartë të Drejtësisë:

a) në fillim të çdo viti kalendarik ndarjen e gjyqtarëve të gjykatës që ai drejton në dhoma gjykimi dhe seksionet përkatëse. Kryetari i gjykatës njofton menjëherë çdo ndryshim të ndarjes së gjykatës për nevoja pune;

b) ngarkesën individuale të punës për çdo gjyqtar, javën e parë të çdo tremujori kalendarik.

Në ngarkesën individuale të punës për gjyqtarët e rretheve gjyqësore, do të përfshihen të gjitha çështjet ku ata gjykojnë me kompetencë individuale ose kolegjiale sipas nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nenit 13 pika 3 të Kodit të Procedurës Penale;

c) numrin e çështjeve që çdo gjyqtar është deleguar, javën e parë të çdo tremujori kalendarik.

2. Pavarësisht nga detyrimi i mësipërm, Kryeinspektori i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në vlerësim të informacionit të disponueshëm prej Këshillit dhe nevojës për njohjen e situatës më të fundit në një gjykatë, kur vlerëson se të dhënat i shërbejnë për çështje të mundshme për delegim nga një gjykatë konkrete, në çdo kohë mund të kërkojë informacionin nga gjykata me kompetencën lëndore në distancë më të afërt mbi ngarkesën e punës të secilit gjyqtar.

Neni 4

Përjashtimi nga delegimet

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për shkak të përgjegjësiave të tjera që vijnë nga ushtrimi i funksionit respektiv dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje, të përjashtohen nga lista e gjyqtarëve që delegohen.

2. Kryetarët e gjykatave të rretheve gjyqësore dhe atyre të apeleve, për shkak të përgjegjësiave të tjera që vijnë nga ushtrimi i funksionit respektiv, përfshihen te listat e gjyqtarëve që delegohen në masën 50% të volumit të çështjeve.

3. Anëtarët e Kolegjit Zgjedhor, për shkak të ngarkesës në mosmarrëveshjet zgjedhore, përjashtohen nga lista e gjyqtarëve që delegohen në vitin zgjedhor.



4. Me kërkesë të motivuar të gjyqtarit dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme provuese, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos përjashtimin deri në gjashtë muaj të një gjyqtari nga lista e gjyqtarëve që delegohen për arsye shëndetësore.

5. Me kërkesë me shkrim të gjyqtarit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos përjashtimin deri në tre muaj të një gjyqtari, i cili është caktuar me delegim në 10 çështje gjyqësore ose në 5 çështje në gjykatat për krime të rënda.

Neni 5

Shqyrtimi i kërkesës për delegime

1. Kryeinspektori i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përgatit kërkesat e paraqitura për delegime në një tabelë, së bashku me materialet shoqëruese, të cilat i paraqiten për shqyrtim në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Dokumentacioni i mësipërm shoqërohet me një relacion të detajuar të kryeinspektorit të Këshillit, i cili, në zbatim të kriterëve të delegimit dhe për çdo çështje apo grup çështjesh që i përkasin së njëjtës gjykatë, i propozon Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjykatat dhe gjyqtarët që duhen përzgjedhur me short sipas këtij vendimi.

3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë vlerëson zbatimin e kriterëve të delegimit nga kryeinspektori sipas përcaktimeve të nenit 6 pikat 1 dhe 3 të këtij vendimi dhe mund të konfirmojë propozimin e paraqitur, ose të vendosë ndryshe.

Neni 6

Procedura e ndarjes së çështjeve për delegim

1. Në kuptim të përcaktimeve në këtë dispozitë, gjyqtarët që përmbushin kriteret e delegimit, janë gjyqtarët e gjykatës të të njëjtë nivel, në distancën më të afërt gjeografike dhe që gjykojnë në të njëjtën dhomë gjykimi ose seksion brenda dhomës civile, së cilës do t'i kalonte për shqyrtim çështja gjyqësore që delegohet.

2. Përcaktimi i gjyqtarit/trupit gjykues që do të shqyrtojë një/disa çështje të deleguar/a nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, do të bazohet në përcaktimin e:

a) numrit të përgjithshëm të çështjeve në të cilat do të delegohet gjyqtari/trupi gjykues;

b) çështjes/çështjeve konkrete për të cilën/cilat do të delegohet gjyqtari/trupi gjykues.

3. Ndarja e çështjeve të sjella për delegim mes gjyqtarëve, që përmbushin kriteret e delegimit, do të përcaktohet duke ruajtur një raport të përpjesëtuar mes numrit të çështjeve të sjella dhe ngarkesës së punës së gjyqtarëve.

a) Numri i çështjeve të cilat do të delegohen gjyqtarët, që përmbushin kriteret e delegimit, bëhet duke mbajtur në konsideratë ngarkesën individuale të gjyqtarit.

b) Kur ngarkesa mes gjyqtarëve që plotësojnë kriteret e delegimit për shqyrtimin e çështjeve, është e diferencuar, për sa është e mundur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë përcakton numrin e çështjeve që do të marrë çdo gjyqtar në përpjesëtim me ngarkesën e tyre.

4. Pas përcaktimit të numrit të çështjeve që do t'i delegohet çdo gjyqtari, që përmbush kriteret e delegimit, përcaktimi i çështjeve konkrete për secilin gjyqtar do të kryhet me short. Shorti zhvillohet përmes sistemit elektronik të ndërtuar për këtë qëllim.

5. Në përzgjedhjen e gjyqtarëve në rastet e çështjeve të sjella për delegim nga gjykatat e apelit, fillimisht zgjidhet me short gjykata e apelit sipas rregullave të mëposhtme:

a) për çështjet e sjella për delegim nga Gjykata e Apelit Durrës, përzgjidhen me short gjykatat e apelit Shkodër, Tiranë dhe Korçë, si dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda;

b) për çështjet e sjella për delegim nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, përzgjidhen me short gjykatat e apelit Korçë dhe Vlorë, si dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda;

c) për çështjet e sjella për delegim nga Gjykata e Apelit Korçë, përzgjidhen me short gjykatat e apelit Gjirokastrë, Vlorë, Durrës, si dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda;

ç) për çështjet e sjella për delegim nga Gjykata e Apelit Vlorë, përzgjidhen me short gjykatat e apelit Gjirokastrë, Korçë, Durrës dhe Shkodër, si dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda;

d) për çështjet e sjella për delegim nga Gjykata e Apelit Tiranë, përzgjidhen me short gjykatat e apelit Shkodër dhe Durrës, si dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda;

dh) për çështjet e sjella për delegim nga Gjykata e Apelit Shkodër, përzgjidhen me short gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Vlorë, si dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

6. Nëse kërkohet delegimi i një gjyqtari në një çështje gjyqësore, ku janë përcaktuar më parë gjyqtarë me delegim, atëherë gjyqtari përzgjidhet me short nga e njëjta gjykatë që është përzgjedhur më parë gjyqtari për delegim. Ky rregull zbatohet vetëm kur numri i gjyqtarëve në gjykatën ku ata përzgjidhen për delegim është më i lartë se numri i gjyqtarëve që duhen deleguar.

Neni 7

Ndarja e çështjeve në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda

Ndarja e çështjeve të sjella për delegim nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda zhvillohet mes gjyqtarëve të të gjitha gjykatave të apelit, duke zgjedhur fillimisht me short gjykatën nga do të përzgjidhen gjyqtarët.

Neni 8

Ndarja e çështjeve në gjykatat me seksione penale për të miturit

